

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo  
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansija  
 Ministry of Finance  
 Arkiva - Arhiva - Archive

Nivelo QD-  
 Org. Zëmit  
 Org. Unit: 06/400

Nr. Prot.  
 Prot. No.: 1368-1/2022

Nr. Kopjeve  
 Broj stranica  
 No pages: 7

Datë  
 Datum  
 Date: 27.06.22

PRISHTINE



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansija  
 Ministry of Finance  
 Arkiva - Arhiva - Archive

Nivelo QD-  
 Org. Zëmit  
 Org. Unit: DL

Nr. Prot.  
 Prot. No.: 3800/22

Nr. Fajet  
 Pristina  
 No Pages: 6

Data  
 Datum  
 Date: 4.7.22

PRISHTINE

Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -

Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Buxhetit - Budget Department - Budzet Departament

<b>DATË</b>	27.06.2022
<b>REFERENCË</b>	NI6-110/2022
<b>PËR/ZATO:</b>	Z. Florje Kika, Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
<b>CC</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	Z. Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Z. Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinionimi i Departamentit të Buxhetit për vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për Studimin e Fizibilitetit dhe projekt – Idesë për Lidhjen Hekurudhore Durrës-Prishtinë

E nderuara znj. Kika,

Bazuar në kërkesën për vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për Studimin e Fizibilitetit dhe projekt – Idesë për Lidhjen Hekurudhore Durrës-Prishtinë, të paraqitur nga propozuesi: Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), obligimin sipas Nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe sipas Nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Departamenti i Buxhetit paraqet me sa vijon:

**ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKTLIGJIT**

Qëllimi i këtij ligji është ratifikimi i “Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për Studimin e Fizibilitetit dhe Projekt – Idesë për Lidhjen Hekurudhore Durrës-Prishtinë”.

## OPINIONI I PAVARUR I DEPARTAMENTIT TË BUXHETIT NË VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB)

Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëfinancimit për Studimin e Fizibilitetit dhe projekt – Idesë për Lidhjen Hekurudhore Durrës-Prishtinë në mes të Republikës së Kosovë dhe Republikës së Shqipërisë, kosto totale e këtij projekti është €1,980,000 prej të cilave obligimi i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë përmes Ministrisë së Infrastrukturë dhe Energjisë është €1,000,000 ndërsa obligimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është €980,000.

Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si organ propozues, ka përgatitur vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për Studimin e Fizibilitetit dhe projekt – Idesë për Lidhjen Hekurudhore Durrës-Prishtinë, dhe e ka paraqitur përmes formularit të vlerësimit të ndikimit buxhetor, sipas të cilit vlerësohet se ky projektligj ka kosto totale prej 980,000€ për vitin 2022.

Në ndarjet buxhetore të planifikuara me Ligjin Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023 dhe 2024 për projektin në fjalë për vitin 2022 është paraparë shuma prej 980,000€, në kategorinë e shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve tek nën programi Departamenti i Transportit Tokësor.

### Përfundim:

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit vlerëson se Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për Studimin e Fizibilitetit dhe projekt – Idesë për Lidhjen Hekurudhore Durrës-Prishtinë, nga aspekti i ndikimit buxhetor nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022. Ky projekt është i buxhetuar me Ligjin Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 dhe vlerësimeve 2023-2024 në shumë prej 980,000€ për vitin 2022 në kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime tek nën programi Departamenti i transportit tokësor që funksionon në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Përgatitur nga:

Fëllanza Mekuli, Analiste e lartë e buxhetit

Konfirmoi:

Milaim Aliu, Udhëheqës i divizionit të buxhetit qendror